



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Komunës së Gjakovës-Pjesa e I-rë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2942-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-038-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "One-Grup" sh.p.k., e dt.25.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Komunës së Gjakovës-Pjesa e I-rë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2942-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-038-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 11.04.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 11.04.2025;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**



Arsyetim

Operatori ekonomik "One-Grup" sh.p.k. me dt.25.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Komunës së Gjakovës-Pjesa e I-rë", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2942-5-2-1, Nr. i brendshëm- 632-25-038-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja lidhur me kriteret që kanë të bëjnë me makineritë dhe stafin teknik, janë të pa bazuara. Autoriteti kontraktues konsideron se kërkesat në FDT, janë të domosdoshme, duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me ndërtimin e rrugëve.

Këto kriteret janë përcaktuar jo të kufizojnë konkurrencën dhe nuk përbëjnë pengesë për pjesëmarrje të drejtë në procedurë, por kanë për qëllim të sigurohet që operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë kapacitet për të përmbushur me sukses detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

